



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 79, datë 24.04.2019

PËR

**MIRATIMIN E PROSPEKTIT TË EMETUESIT SHOQËRIA “FONDI BESA” SH.A.,
PËR OFERTËN PRIVATE TË EMETIMIT TË OBLIGACIONEVE AFATGJATË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe të nenit 30, të Ligjit nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Bordi i Autoriteti të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e prospektit të emetuesit, shoqëria “Fondi Besa” sh.a., për ofertën private të emetimit të obligacioneve afatgjatë me normë interesi fikse për shumën 100,000,000 lekë, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin KOÇI